



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 1145/2019  
Data: 09.12.2019

**PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e njëmbëdhjetë -XI- për vitin 2019 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 19.11.2019 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Sevime Laçi (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), Medina Imishti (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie, Sociale), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Përfaqësuesi i OSB-së. Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnje anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i propozim vendimit për caktimin e normave tatimore të tatimit në pronën e paluajtshme të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.
3. Shqyrtimi i propozim vendimit për transfer në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje për vitin 2019.
4. Shqyrtimi i propozim vendimit për planin komunal për riintegrin të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar për vitet 2019-2022.
5. Shqyrtimi i kërkesës së z. Avdi Dernjani për ndërrim destinim të pronës.
6. Shqyrtimi i kërkesës së z. Ilir Bushi për ndërrim destinim të pronës.
7. Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e subvacioneve në bujqësi.
8. Shqyrtimi i informatës lidhur me progresin për zbatimin e rekondicioneve të auditimit për vitin 2018.
9. Shqyrtimi i informatës mbi gjendjen në shëndetësi gjatë muajve Janar-Tetor 2019.
10. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**MIRATOHET RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- në faqe tre diskutimi im duhet të jetë nëse shkohet përmes zonës kadastrale Lagjja e Re duhet të shkon me fshatin Seçishtë dhe Lagjja e Ujit të Thart ka pjesë që shkojnë në Pustenik dhe ka pjesë që shkojnë me Paldenicë. Duke pasur për bazë shtrirjen e këtyre lokaliteteve nuk kemi shkuar sipas zonave kadastrale por sipas shtrirjes gjeografike.

**Kryesuesi thekson:-** a keni edhe ndonjë vërejtje për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

#### MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

- 2. Shqyrtimi i propozim vendimit për caktimin e normave tatimore të tatimit në pronën e paluajtshme të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- sipas ligjit komunat nuk miratojnë rregullore por vetëm vendim mbi normat tatimore të cilat kuvendi i komunës ka drejtë me i caktuar. Te neni dy pika gjashtë dhe tetë duhet të ndryshohet dhe të jetë 15 %. Ministria i ka përcaktuar pesëmbëdhjetë nivele të zonave por raportin do t'ua përcjelli për kuvend më gjerësisht.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- a përfshihen edhe pronat bujqësore për shkak se është problem çështja e pronësisë sepse qytetarët kanë probleme për shkak se pronat i kanë në emër të babagjyshit dhe nuk e dimë se kujt i takon çështja e pagesës. Komuna është dashur me menduar për me bërë zgjidhje që fillimisht me rregulluar çështjen e pronave para se me filluar implementimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- ky vendim është që aplikohet në nivel të Republikës së Kosovës sepse vendimin e ka marr Qeveria e Kosovës. Neve si komuna ky vendim do të na shkakton probleme për shkak se mund të grumbullohen borpoxha dhe është problem se cilit me iu drejtar që ti ke obligim ndaj komunës për me paguar. Komuna mund të bënë një fushatë te qytetarët për me rregulluar çështjen e pronave të cilat i keni në emër të paraardhësve të juaj. Me sa jam i njoftuar për fshatin Seçishtë, Gorancë, Paldenicë është bërë rikonfigurimi i kadastrit dhe komuna nuk mund të bënë asgjë në këtë drejtim sepse janë çështje private që familjet duhet me i bërë. Komuna nuk merr vendim për rikonfigurim por Drejtoria e Gjeodezisë e Republikës së Kosovës dhe komuna nuk mund të bënë lehtësim për këtë çështje.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është mirë me gjet një alternativë që qytetarëve me ua lehtësuar procedurat sepse si vendim nuk po e kontestojmë por është mirë që komuna me gjet një zgjidhje që qytetarëve me u bërë lehtësime te ndarja e parcelave për shkak se çështjet të cilat kanë të bëjnë me gjykatë ne e dimë që iu takojnë qytetarëve vet me i kryer. Komuna mundet ta bënë një projekt për këtë çështje dhe ta kontraktonte një kompani të licencuar dhe t'i bënë matjet në teren dhe krijimin e parcelave. Në qoftë se komuna do t'i kryen shërbimet për matje qytetarëve do t'ua lehtësonte shumë punën sepse pagesat e gjeodetëve për me bërë matje në teren kanë kosto më të lartë se shpenzimet e tjera. Për fshatrat që nuk është bërë rikonfigurimi i kadastrit ashtu siç u përmendën më lartë është mirë që komuna me marr iniciativë edhe për fshatrat që kanë mbetur për shkak se në të ardhmen më lehtë do ta ketë që me iu drejtar qytetarit për me kryer tatimin sepse ju e dini që shumë familje janë të ndara dhe ende nuk kanë bërë ndarje fizike të pronave.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

#### **U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE NË PRONËN E PALUAJTHME TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **3. Shqyrtimi i propozim vendimit për transfer në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje për vitin 2019.**

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- nga Ministria e Financave – departamenti i thesarit na është dërguar një shkresë që komunat të cilat kanë minus nëpër drejtori të bëhet harmonizimi në kategorinë në paga dhe mëditje. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- cilat kritere janë marr që e keni ndarë nëpër kategori transferin e mjeteve financiare, çka është marr për bazë që keni propozuar me i ndarë këto mjete financiare?

**Shabi Rexhallari** thekson:- mjetet kemi planifikuar me i dërguar në ato drejtori për shkak se kemi dhënë pagat jubilare për shërbyesit civil të cilat nuk i kemi pasur të parapara.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

#### **U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR TRANSFER NË KATEGORINË EKONOMIKE PAGA DHE MËDITJE PËR VITIN 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **4. Shqyrtimi i propozim vendimit për planin komunal për riintegrin të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar për vitet 2019-2022.**

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin,

**Edon Curri** thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

#### **U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR PLANIN KOMUNAL PËR RIINTEGRIM TË QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR PËR VITET 2019-2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **5. Shqyrtimi i kërkesës së z. Avdi Dernjani për ndërrim destinim të pronës.**

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Zaim Bela** thekson:- udhëzimi administrativ e parashev që kuvendi të merr vendim për ndërrim destinim të pronës e cila është e klasit 5 dhe 6. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

#### **U VOTUA KËRKESA E z. AVDI DERNJANI PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## **6. Shqyrtimi i kërkesës së z.Ilir Bushi për ndërrim destinim të pronës.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Zaim Bela thekson:-** edhe kjo kërkesë ka të bëjë me ndërrim destinim nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

## **U VOTUA KËRKESA E z.ILIR BUSHI PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **7. Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e subvencioneve në bujqësi.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Zaim Bela thekson:-** të gjitha informacionet rreth subvencioneve që i ka dhënë komuna dhe OJQ Labi i kemi përfshirë në material dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** në marrëveshjen që keni bërë me LAB-in pse çështjet e prokurimit i ka udhëhequr LAB-i dhe cila është leverdia që i ka marr përsipër LAB-i me i udhëhequr procedurat e prokurimit për shkak se më mirë do të ishte që me mbështetur projektin me mjete financiare.

**Zaim Bela thekson:-** kjo çështje ka qenë lehtësim për zyrën e prokurimit për shkak se kanë pasur ngarkesë ata dhe më e arsyeshme ka qenë që mjetet me ia dërguar LAB-it.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

## **U VOTUA INFORMATA MBI NDARJEN E SUBVENCIONEVE NË BUJQËSI QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **8. Shqyrtimi i informatës lidhur me progresin për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin 2018.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari thekson:-** kemi bërë komisionin dhe ka filluar lidhur me zbatimin e rekomandimeve. Nga shtatë rekomandimet të cilat i kemi pasur pesë i kemi pjesërisht të zbatuara një plotësisht dhe një nuk është zbatuar. Këtu bëhet fjalë për gjendjen deri në shtator. Pika e parë ka qenë opinioni i pa modifikuar me theksim të çështjes dhe është bërë regjistrimi por nuk mund të themi që ka përfunduar për shkak se duhet deri në fund të muajit janar. Opinion i dytë ka të bëjë me çështjen e realizimit të buxhetit jemi pjesërisht sepse për çdo tretë është niveli i ulët i inkasimit të të hyrave nga taksat komunale që për momentin gjendja është mirë por ka ende punë që duhet të kryhen. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka filluar me vërejtje. Pjesa e fundit ka të bëjë me menaxhimin e pasurive jofinanciare dhe komisioni për administratë ka punuar në këtë drejtim dhe ka mbetur komisioni për shkolla dhe komisioni për shëndetësi të cilët do t'i finalizojnë raportet dhe do t'i sjellin në komision dhe komisioni tjetër do t'i regjistron te e-pasuria dhe pastaj me u bërë zhvlerësimi i tyre. Rekomandimi tjetër ka të bëjë me tri drejtori dhe atë me tatimin në pronë dhe me taksa të bizneseve, mirëpo ne kemi marr disa hapa që brenda këtij muaji do t'i dërgojmë vërejtje dhe nëse qytetarët nuk u përgjigjen atëherë do të vazhdojmë me procedurat përmbarimore. Rekomandimi i gjashtë ka të bëjë me mungesën e njësisë së auditimit por ne kemi parashtruar kërkesë Ministrisë së Financave për çështje të auditimit që të na përfshijë në planin për vitin 2019. Në këtë vit është hartuar rregullorja për çështje të auditimit dhe aty parashihet që organizatat që kanë më pak se tre milion euro buxhet funksionimin e auditimit të brendshëm

mund ta ushtrojnë përmes metodave të tjera që faktikisht na bie që mos me pasur auditorë. Rekomandimi i shtatë ka të bëjë me çështjen e dobësimit në kontrolllet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut dhe kemi filluar me përgatitjen e listës së rreziqeve. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi thekson:-** unë mendoj se edhe nëse i plotësojmë këto rekomandime përsëri auditori jep rekomandime të tjera. Pasi auditorë të brendshëm nuk kemi u potencua që komuna do të zgjedhë mënyra të tjera dhe cilën mënyrë do ta zgjedhë komuna me kryer auditimin?

**Shabi Rexhallari thekson:-** në bazë të rregullores kemi bërë kërkësë në ministri që Departamenti i Auditimit që është në kuadër të Ministrisë së Financave me ardhur dhe me bërë auditimin dhe varet prej ministrisë si na sugjeron.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** rekomandimet të cilat janë dhënë prej auditorit janë për me u përmirësuar më mirë. Te këto ku ju keni vepruar po i shohë më shumë si raportime dhe cilët janë mekanizmat të plotësimit të rekomandimeve të cilat i ka dhënë auditori.

**Shabi Rexhallari thekson:-** shablonin të cilin e kemi marr prej zyrës së auditorit është format dhe është dashur me i shënuar hapat për secilën të gjetur. Në bazë të këtij formati do ta shohim situatën se ku kemi arritur duke u bazuar në raporte.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

## U VOTUA INFORMATA LIDHUR ME PROGRESIN E REKOMANDIMEVE TË AUDITIMIT PËR VITIN 2018 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

### 9. Shqyrtimi i informatës mbi gjendjen në shëndetësi gjatë muajve Janar-Tetor 2019.

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Medina Imishti thekson:-** meqë po e kemi buxhetin e njëjtë nuk po pritet me pasur shumë ndryshime sepse po janë aktivitete të vazhdueshme dhe të obligueshme të cilat po kemi me i realizuar. Për vitin 2019 e kemi bërë një plan të veprimit për kujdesin parësorë shëndetësorë për QKMF-në të cilin janë tri objektiva infrastrukturë dhe pajisje, në staf dhe në promovim të shëndetësisë. Materialet i keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** faqe dy kontratë për kryerjen e shërbimeve të analizave fiziko kimike mikrobiologjike të ujit në Han të Elezit me institutin e ujit të shëndetit publik dhe a janë bërë analiza të ujit?

**Medina Imishti thekson:-** janë bërë nëntë analiza nëpër qeshmet publike.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** për mbledhje të kuvendit kërkoj që të na sillen analizat të cilat janë bërë në mënyrë që në të ardhmen me bërë edhe nëpër puset private. Te raporti i shpenzimeve vetura Renault shënon 278 litra derivate dhe nëse krahasohet me 1,440 km dalin që 750 apo më shumë dhe i bie që mbi 20 litra ka shpenzuar më shumë. Është mirë të vërtetohet kjo dhe të përmirësohet për mbledhje të kuvendit të komunës. A ka punëtorë në QKMF me kontratë në vepër që i ka zgjatur me vite dhe kërkoj që të na dërgohet për kuvend në mënyrë që të shikohet një pasqyrë për këtë çështje?

**Nora Xhoni thekson:-** rastet e personave me kancer është mirë me i specifikuar dhe me krahasuar me vitin e kaluar.

**Medina Imishti thekson:-** në rapport vjetorë do t'i përcillen.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA INFORMATA MBI GJENDJEN NË SHËNDETËSI GJATË MUJAVE JANAR-TETOR 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**10. Të ndryshme.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nuk pati diskutime.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:31

Procesmbajtësi

Avni Bushi

